

AKT –THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AL CONSTRUCTION” shpk

Sot më datë 18/02/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë),

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, " Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin tone të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi me ortakët :

1. **Festim Bregasi**, atësia Agron, mëmësia Hënë, lindur më 09.10.1983, në Çorovodë, Skrapar, dhe banues në Durrës me adresë: Lagjia Nr. 6, Rr. “Aleksandër Goga”, Durrës, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me kartë identiteti (ID) Nr. Personal I31009048M
2. **Henri Çela**, atësia Skënder, mëmësia Valbona, lindur më 13.08.1996, në Tepelenë, dhe banues në Tiranë me adresë: Rr. “Ali Visha”, Nd.69, H.2, Ap.9 Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me kartë identiteti (ID) Nr. Personal J60813050B

krijojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “AL CONSTRUCTION” sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Neni 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria “AL CONSTRUCTION” shpk është e llojit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe do të quhet Shoqëria “AL CONSTRUCTION” shpk.

Neni 2

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Shoqëria “AL CONSTRUCTION” shpk do të veprojë për një periudhë kohore më shumë se 10 vjet.

Neni 3

EMËRTIMI DHE QËNDRA (SELIA)

Shoqëria “AL CONSTRUCTION” shpk do të ketë qendrën (selinë) e saj në Qarkun Gjirokastrë, me adresë: Tepelenë, Lagjia “Mustafa Matohiti” , Rr. “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe .

Neni 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Aktivitet në fushën e projekteve, zbatimit të veprave të ndërtimit dhe rikonstruksioneve, vleresime të pasurive të paluajtshme, sipërmarrje të ndryshme private dhe shtetërore; investitor privat në fushën e ndërtimit të objekteve të ndryshme civile private dhe shtetërore, social-kulturore, ndërtim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, ura , viadukte etj. Ndërtime dhe rikonstruksione hidrocentrale , diga të të gjitha madhësive ,ujësjellësa, kanale të ujërave të zeza dhe të bardha, gazësjellësa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore sistemim hidraulike e bonifikime dhe agjenci për shitblerjen e këtyre ndërtimeve; Ndërtim dhe rikonstruksion linjash tensioni të ulët të mesëm dhe të lartë; Ndërtim dhe rikonstruksion porte, aeroporte;

Tregtim i materialeve inerte, produkteve të ndryshme prej betoni, si dhe materialeve të ndryshëm për ndërtim. Tregëtim të materialeve prej duralumini dhe plastike;

Shërbime specicioni brenda dhe jashtë Shqipërisë për transport mallrash të ndryshme me shumice e pakicë, import-eksport me mjete të shoqërisë.

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshëm ushqimore industriale, bujqësore, elektro-shtëpiake, kancelari, pjese kompjuterike, blegtorale të mishit dhe nënprodukteve të tij, sallameri e çdo nënprodukt të tij, shpendëve të gjalla e të therura;

Tregëtim, eksport-import me shumicë dhe pakicë të makinerive bujqësore, pjesë të këmbimit për këto makineri, autoservis i tyre, autoservis mjetesh të markave e tonazheve të ndryshme, tregëtim me pakicë i llojeve të ndryshme, të karburantit dhe nënprodukteve të tij, hoteleri, shërbim agjenci turisitike, projekte objekteve të ndryshme dhe hapje studiosh projektimesh, prodhim material ndërtimi dhe tregtimi i tyre.

Eksport - import dhe tregtim me shumice dhe pakicë të makinerive industrial dhe pjesëve të këmbimit, për këto makineri, linjë transporti, linjë prodhimi industrial e drusor, artikujve shkollor dhe kancelarisë dhe mobileri zyre: letrës për shtypshkrim, fotokopje etj, pajisje, kondicionimi dhe ventilimi, pajisje kompjuterike, printimi, fotokopjimi si dhe çdo pajisje elektronike apo elektrike që gjen në përdorim zyre si dhe pjesë këmbimi për to si dhe të ofrojë të gjitha shërbimet që kryhen me pajisjet e sipërpërmendura; shërbime riparimi të këtyre pajisjeve;

Transport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial si: lëndë të para, material ndërtimi, makineri dhe pajisje, pjesë këmbimi për makineri e automjete etj;

Neni 5 REGJIMI JURIDIK

Në të gjithë territorin e saj në Republikën e Shqipërisë, Shoqëria do të udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë dhe të ortakëve të shoqërisë janë përcaktuar saktësisht në statut.

Shoqëria gëzon mbrojtje dhe siguri të plotë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për evidentimin e veprimtarisë së Shoqërisë do të përdoren dispozitat ligjore në fuqi dhe kërkesat e përgjithshme të kontabilitetit, siç sqarohet më hollësisht në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë.

Neni 6 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë i Shoqërisë do të jetë:



Në Lek – 100.000,00 (njëqind mijë) lekë, numri i pjesëve 2 (dy) me vlerë 50.000, 00 (pesëdhjetë mijë) lekë secili .

Kapitali i ndarë në përqindje dhe në para per ortakët e shoqërisë është si më poshtë :

1. *Festim Bregasi - 50 (pesëdhjetë) % ; dhe kontribut në para me 50.000, 00 (Pesëdhjetë mijë) lekë*
2. *Henri Çela - 50 (pesëdhjetë) % ; dhe kontribut në para me 50.000, 00 (Pesëdhjetë mijë) lekë*

Kapitali i shoqërisë do të rritet krahas ecurisë së saj ekonomike, financiare si dhe të vendimeve që do të marrim ortakët e saj për ta rritur atë në të ardhmen.

Neni 7

DREJTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i saj, përfaqësuesi ligjor i saj ne marrëdhënie me të tretët dhe në drejtimin e saj.

Asambleja e përgjithshme do ti marrë të gjitha vendimet e saj me shumicë të kualifikuar.

Neni 8

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Konfliktet që mund të lindin do te zgjidhen në zbatim të Legjislacionit Shqiptar.

Neni 9

VULA DHE STEMJA

Shoqëria "AL CONSTRUCTION" shpk do të ketë vulën dhe stemën e saj.

Neni 10

LEGJISLACIONI

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote të normave te statutit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Për shoqëritë tregtare" si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Neni 11

Dispozita të fundit

Akti i themelimit u përpilua në 2 (dy) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë

ORTAKËT

Festim BREGASI

Festim Bregasi


Henri ÇELA

Henri Çela
